

VENDIM
Nr. 65, datë 12.4.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 116, DATË 24.5.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SPV BLUE 1’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ‘BLUE 1’ ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINASIT, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 833/1 prot., datë 8.4.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV BLUE 1’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’ me vendndodhje në zonën e Sheq Marinasit, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw’”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.5.2022, të ndryshuar me vendimin nr. 202, datë 23.6.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar duke filluar nga data e operimit, por jo më vonë se data 1.4.2024.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 833 prot., datë 28.3.2024, i licencuari “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka kërkuar ndryshimin e datës së fillimit të operimit, duke argumentuar se punimet për ndërtimin e parkut fotovoltaik “Blue 1” janë në fazën përfundimtare për të vijuar më pas me energjizimin dhe testimet përkatëse të veprës. Meqenëse punimet për ndërtimin e nënstacionit 220/110/35/20 kV Hoxharë, si dhe të linjës së transmetimit 220 kV, që lidh nënstacionin Hoxharë 220/110/35/20 kV me linjën Fier–Babicë janë ende në proces realizimi, energjizimi dhe operimi i parkut fotovoltaik “Blue 1” mbetet në funksion të realizimit të investimeve nga OST-ja.

- Për sa më sipër, shoqëria ka kërkuar nga ERE që afati i fillimit të operimit të parkut fotovoltaik “Blue 1” të konsiderohet momenti i energjizimit dhe depozitimit të të dhënave të testimit/komisionimit të parkut fotovoltaik “Blue 1” pranë ERE-s.

- Në rrethanat kur shoqëria nuk ka filluar ende me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar, vlerësojmë të justifikuar kërkesën e saj për të filluar afatin 25-vjeçar të vlefshmërisë së licencës nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të parkut fotovoltaik “Blue 1”, duke marrë në konsideratë se kjo nuk afekton as përcaktimet e kontratës nr. 2720 rep., nr. 2066 kol., të datës 9.7.2021, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar. Në nenin 9, pika 2 e kësaj kontrate është parashikuar që mbajtësi i miratimit merr përsipër të vërë në punë parkun fotovoltaik, brenda 60 muajve nga marrja e të gjitha lejeve për fillimin e punimeve.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, i ndryshuar, bëhet si vijon:

1.Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të centralit, por jo më vonë se data 9.7.2026.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi